

SHËNIMET SPJEGUESE

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2. Plotesimi i të dhënave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte të përcaktuara në SKK 2 dhe konkretisht paragrafeve 49-55. Radha e dhenies së shpjegimeve duhet të jete:

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
- b) Shënimet që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënime të tjera shpjeguese

Informacion i përgjithshëm

ME-AJ ENERGY SH.P.K është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në Tiranë Datë 16/06/2008 në përputhje me ligjin 'Për shoqëritë tregtare' dhe statutin e saj. Veprimtaria kryesore e shoqërisë është në fushën e konsulencës teknike dhe ligjore për vepra hidrike, ndërtime etj, Kjo veprimtari rregullohet nga statuti i shoqërisë dhe ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 'Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare'.

Administrator i shoqërisë është z. Perparim Golli. Selia e shoqërisë ndodhet në Rr. 'Donika Kastrioti' Nr.4, Tiranë. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 100,000 Lekë.

Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare u plotësuan sipas Standartit Kombëtar të Kontabilitetit Nr.2 dhe Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Ndërtimi i tyre u bë nga përpunimi me metoda kontabile të të gjithë dokumentacionit që pasqyron veprimtarinë e shoqërisë në periudhën raportuese të vitit 2020.

Më poshtë po japim shpjegime për përmbajtjen e zërave të pasqyrave financiare:

A. Per Aktivet:

1. Mjetet monetare

Mjetet monetare në arke dhe në bankë detajohen si më poshtë më 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Gjendje në Bankë	38,163	157,323
Gjendje në Arkë	100,000	100,000

Nr.	Emri i Bankës	Monedha	Vlera në Valutë	Vlera në Lekë
1	BKT	LEKË	0	38,163

2. Të drejta të arkëtueshme nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesmarrëse

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
2.1 Kuota në Shoqërinë 'Diteko' shpk	35,000	35,000
2.2 Kontribut në Shoqërinë 'Diteko' shpk	3,462,500	3,462,500

3. Të drejta të tjera të arkëtueshme

Për shkak së shoqëria nuk zhvillon ende aktivitet tregtar, shpenzimet e periudhës ushtrimore paraqiten si shpenzime të shtyra. Në zërin Shpenzime të Shtyra për vlerën prej 3.845.156 paraqitet 3.327.152 Lekë mbartje nga Viti 2019 Plus Taksa Vendore = 74.500 Lekë, Komisione Bankare 6.200 Lekë, Shpenzime page të llogaritura të administratorit = 317.304 Lekë, Shpenzime qeraje 120,000 Lekë.

**ME-AJ energy sh.p.k.**
Tiranë - Albania

B. Për Detyrimet:

4. Te pagueshme ndaj punonjesve

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Paga e administratorit, detyrim nga viti paraardhës 1,384,064 Lekë dhe Detyrim 2020 në vlerën 306,696 Lekë për pagat e pa dhëna Janar - Dhjetor 2020.	1,690,760	1,384,064

5. Detyrime Tatimore

Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore
Tatimi në Burim

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
	884	884
	<u>2321</u>	<u>2321</u>
	3205	3205

6. Detyrime të tjera

Detyrime ndaj Ortakut

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
	5,792,834	5,792,834

C. Të ardhurat dhe Shpenzimet:

Shoqëria nuk ka kryer aktivitet dhe nuk ka realizuar të ardhura për vitin 2020

7. Angazhime dhe pasiguri

Cështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesit të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkoj rregullime të këtyre Pasqyrave Financiare.

Detyrime tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

8. Ngjarjet pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto Pasqyra Financiare

ADMINISTRATORI

ing. PERPARIM GOLLI

